

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7835
E hënë, 15 korrik 2024
Çmimi 0.50

Kurti me ofertë për
mërgimtarët që duan të
investojnë në Kosovë

FACE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AUTORITETET AMERIKANE PO TENTOJNË TA ZBULOJNË MOTIVIN E ATENTATIT
NDAJ ISH-PRESIDENTIT TË SHBA-SË, DONALD TRUMP

FAQE 4-5

TRUMPI I SHPËTON ATENTATIT



Ish-presidenti i ShBA-së dhe kandidati i pritur republikan në zgjedhjet presidenciale të nëntorit, Donald Trump, i ka shpëtuar një atentati në një tubim në Pensilvani pas disa të shtënave me armë. Në një video, e cila qarkulloi menjëherë pas atentatit, Trumpi vendos dorën në

veshin e djathtë dhe më pas shërbimet sekrete ndërhyjnë duke e shtrirë në tokë dhe duke iu hedhur sipër. Trumpi më pas çohet në këmbë me katër anëtarë të shërbimeve sekrete, të cilët e rrethojnë atë dhe, në shenjë demonstrative, i gjakosur në pjesën e

djathtë të fytyrës, ish-presidenti amerikan ngrë grushtin lart, duke përjetësuar një shkrepje, e cila bëhet menjëherë faqe e parë e medieve botërore, me titull "Trumpi u shpëton të shtënave në Pennsylvania". Agjentët amerikanë e kanë vvarë sulmuesin në vendngjarje

AKTUALE



**GJUKANOVIQIT I SHTOHEN MASAT
E SIGURISË PAS INFORMACIONEVE
PËR ATENTAT** F.2

**SULMOHET ME KOKTEJ MOLOTOVI
NJË LOKAL NË VERI QË SVEÇLA E
KISHTE VIZITUAR** F.6

**HARADINAJ: GJITHÇKA
QË NDËRTON KURTI ËSHTË NË
THEMELET E TJETËRKUJT** F.3

EKONOMI



**RRETH 800 G-JOBA JANË
SHOIPTUAR PËR GJASHTË MUAJ
NGA INSPEKTORATI I PUNËS** F.7

**PUNËSIMI NË KOSOVË, STATISTIKA
TË MANIPULUARA APO REALE?** F.7

SPORT



SPANJA, KAMPIONE E EVROPËS F.10

**RAKIPI: BISEDIMET
KOSOVË - SERBI
TË PËRQENDROHEN
TE NJOHJA,
JO MË NË ÇËSHTJE
TEKNIKE** F.3



LULEDIELLI MBULON TOKAT E KOSOVËS F.6



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Alfred Belerit i lejohet të shkojë në Strasburg për t'u betuar si eurodeputet

TIRANË, 14 KORRIK - Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve në Shqipëri njoftoi të dielën, më 14 korrik, se ka miratuar kërkesën e Alfred Belerit që të dalë nga burgu në mënyrë që ta bëjë betimin si eurodeputet në Strasburg.

Beleri u zgjodh deputet i Greqisë në Parlamentin Evropian, teksa po vuan dënimin prej dy vjetësh burgim në Shqipëri për vjedhje votash në zgjedhjet lokale të vitit 2023.

Në vendimin e autoriteteve të burgjeve theksohet se leja shpërblyese nis në orën 06:30 të së hënës deri në orën 16:00 të datës 20 korrik. Gjithashtu përcaktohet se leja duhet detyrimisht të kryhet në dy adresat e dhëna prej Belerit, njëra në Himarë, tjetra në Strasburg. Autoritetet thanë se për çdo lëvizje tjetër "të imponuara nga forca madhore" duhet të telefonojë pranë zyrës së informacionit në burgun e Fierit, ku aktualisht Beleri po shlyen dënimin prej dy vjetësh burgim, me akuzën për blerje votash.

Drejtorja e Burgjeve sqaroi në vendimin për lejen shpërblyese se ditën e hënë Beleri duhet të



paraqitet në Komisaratin e Himarës, ku të paraqesë një kopje të vendimit. Gjithashtu, theksohet se nëse nuk ndodhet në Himarë, duhet të mbajë kontakt me komisaratin e këtij qyteti çdo ditë në orën 14:00. Mosrespektimi i këtyre rregullave do ta ngarkojë Belerin me përgjegjësi penale.

Drejtorja e Burgjeve tha se leja shpërblyese u dha në funksion të ndjekjes së punimeve në Parlamentin Evropian me datat 15-20 korrik 2024 në Strasburg dhe se pas përfundimit të lejes pesëditore, i dënuari Alfred Beleri do të kthehet në burgun e Fierit për ta vazhduar kryerjen e

dënimit, sipas vendimit të Gjykatës së Posaçme.

Në mars, Gjykata e Posaçme e dënoi Belerin me dy vjet burgim. Ndërsa më 25 qershor Gjykata e Posaçme e Apelit vendosi ta mbajë në fuqi dënimin e Alfred Belerit, duke e rrëzuar ankesën e tij. Më 5 korrik, Komisioni Qendror i

Zgjedhjeve në Shqipëri vendosi që Alfred Belerit t'i hiqet mandati i kryebashkiakut të Himarës, ndërsa presidenti shqiptar, Bajram Begaj, shpalli 4 gushtin si datën e zgjedhjeve për kryetarin e kësaj bashkie.

Në zgjedhjet për Parlamentin Evropian, në fillim të qershorit, kryeministri grek, Kyriakos Mitsotakis, e emëroi Belerin kandidat të partisë Demokracia e Re. Ai u rendit i katërti mes shtatë eurodeputetëve grekë.

Sipas rregullores së Parlamentit Evropian, pasi rezultatet e zgjedhjeve të jenë zyrtare, shtetet anëtare komunikojnë emrat e atyre që kanë fituar një vend në Parlament dhe presidenti, në anën tjetër, u kërkon autoriteteve përgjegjëse të vendeve anëtare t'i marrin masat e nevojshme për t'i shmangur çështjet që lidhen me papajtueshmërinë e marrjes së detyrës.

Rasti i Belerit përbën dallim nga eurodeputetët e tjerë, pasi është zgjedhur në Greqi - vend i Bashkimit Evropian - dhe vuan dënimin me burgim në Shqipëri, vend që nuk është anëtar i BE-së.

Gjukanoviqit i shtohen masat e sigurisë pas informacioneve për atentat

PODGORICË, 14 KORRIK - Policia malazeze ka shtuar masat e sigurisë ndaj ish-presidentit të Malit të Zi, Millo Gjukanoviq, pas informacioneve se ndaj tij po përgatitet një atentat. Kjo u bë e ditur më 14 korrik, pasi një ditë më parë disa media në Mal të Zi, të cilat duke u thirrur në burime nga sektori i sigurisë, njoftuan se një grup kriminal nga rajoni po përgatitej ta vraste Gjukanoviqin dhe se ish-presidenti i Malit të Zi ishte informuar për këtë nga një anëtar i paidentifikuar i shërbimeve të huaja. "Policia ka marrë informacionin e duhur nga Agjencia e Sigurisë Kombëtare [ANB]. Theksojmë se besueshmëria e informacionit është ende duke u kontrolluar nga ANB-ja. Menjëherë pas marrjes së informacionit, Policia, Prokuroria dhe ANB-ja morën masa të mëtejshme dhe veprime në juridiksionin e tyre në mënyrë të sinkronizuar", thuhet në njoftimin e policisë.

Autoritetet thonë se menjëherë pas marrjes së informacionit nga ana e prokurorisë kompetente është iniciuar rast.

Kryetari i Partisë Demokratike të Socialistëve në opozitë, Danijel Zhivkoviç, është i vetmi që ka njoftuar zyrtarisht se kjo parti "ka dijeni për detajet e përgatitjes për



vrastjen e mundshme të ish-presidentit të Malit të Zi, Millo Gjukanoviq". Ai kështu deklaroi në një konferencë për shtyp më 13 korrik, duke iu përgjigjur pyetjes së një gazetari për informacionet e medieve se po përgatitej një atentat ndaj Gjukanoviqit. "Ne kemi njohuri të detajeve dhe e dimë se për çfarë bëhet fjalë. Nuk na takon neve t'i komunikojmë informacionet tona. Besoj se ANB-ja dhe institucionet e tjera kompetente do të dalin me të dhëna të sakta", tha Zhivkoviç.

Duke iu referuar informacioneve

jozyrtare të medieve të publikuara, Zhivkoviç deklaroi se Gjukanoviq për këtë është paralajmëruar nga qarqet e agjencive të huaja të inteligjencës, por nuk ka dashur të japë detaje.

Duke iu referuar burimeve të paidentifikuara, një pjesë e medieve në Mal të Zi kanë marrë konfirmimin se ANB-ja ka marrë "informacion operacional" për përgatitjen e vrasjes së Gjukanoviqit. Me këtë rast, "Radio Evropa e Lirë" pyeti ANB-në nëse ka marrë "informata serioze operationale se një grup i organizuar kriminal po

përgatitet ta vrasë Gjukanoviqin", siç raportojnë mediet. Ky institucion nuk u përgjigj.

REL i ka dërguar edhe një pyetje zyrës së ish-presidentit nëse është e vërtetë se ai i ka njoftuar organet kompetente për informacionin se po i përgatitet një atentat. Përgjigja nuk erdhi as nga ajo adresë.

Në deklaratën e parë të policisë të lëshuar më 13 korrik, ajo deklaroi se nuk ishte në dijeni të informacionit për përgatitjen e atentatit ndaj Gjukanoviqit.

Në njoftimin e fundit, nga policia sqarohet se në kohën e njoftimeve

në media për përgatitjen e atentatit, "ANB po bashkëpunonte ndërkombëtarisht për verifikimin e atij informacioni". "Ndërsa procedura për përcaktimin e fakteve dhe rrethanave relevante, përfshirë besueshmërinë e tyre, është duke vazhduar, është marrë vendim për forcimin e masave të sigurisë për ish-presidentin e Malit të Zi për arsye parandaluese".

Ish-presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka reaguar ndaj lajmeve për planifikimin e vrasjes së Millo Gjukanoviqit, duke thënë se ky informacion është shumë shqetësues për paqen dhe stabilitetin në këto zona.

Millo Gjukanoviq është themeluesi dhe udhëheqësi i Partisë Demokratike të Socialistëve, partisë që ishte në pushtet në Mal të Zi për tri dekada.

Partia e tij humbi zgjedhjet e vitit 2020 dhe pas humbjes së zgjedhjeve presidenciale të 2023 nga Jakov Milatoviç, Gjukanoviq u tërhoq nga politika.

Pas kësaj u mbajt kongresi i partisë së tij, ku kryetar i ri u zgjodh Danijel Zhivkoviç.

Përveç njoftimeve protokollare nga zyra e ish-presidentit, Gjukanoviqi ka dhënë edhe disa intervista, por ai nuk merr pjesë drejtpërdrejt në jetën politike.

Haradinaj: Gjithçka që ndërton Kurti është në themelet e tjetërkujt

PRISHTINË, 14 KORRIK - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se gjithçka që ndërton Kurti është në themelet e

tjetërkujt. Haradinaj ka thënë se tenderët njëburimorë janë vrima më e madhe e shkaktuar në buxhetin e Kosovës. "Tenderët njëburimorë janë

vrima më e madhe e shkaktuar në buxhetin e Kosovës dhe vetëm atë mund ta quajë historike Albin Kurti, dhe jo për të mirë. Implementimi i

Marrëveshjes për Energji e vitit 2013 nuk është vrimë e mbyllur nga Kurti. Gjithçka që ndërton Kurti është në themelet e tjetërkujt", ka thënë Haradinaj.



Rakipi: Bisedimet Kosovë - Serbi të përqendrohen te njohja, jo më në çështje teknike

PRISHTINË, 14 KORRIK - Kryetari i Institutit për Studime Ndërkombëtare, Albert Rakipi, thotë se ka ardhur koha për një qasje tjetër në dialogun në mes të Prishtinës dhe Beogradit, që do t'i jepte zgjidhje konfliktit të ngrirë mes dy vendeve. Ai shton se zgjidhja duhet të vijë nga lart-poshtë, që do të thotë se të dy vendet duhet ta njohin njëri-tjetrin si shtete të pavarura.

Gjatë intervistës për Zërin e Amerikës, eksperti thotë se formula e ndjekur deri tani, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, ka treguar se nuk ka funksionuar ndaj ai sugjeron reflektim e qasje të re në dialog, gjë që kërkon, siç tha, angazhimin e BE-së, por në mënyrë të veçantë atë të Shteteve të Bashkuara. "Duhet pranuar që nuk ka progres në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë dhe, siç e kemi parë, ka një mungesë vullneti total nga ana e Serbisë për t'i zbatuar marrëveshjet. Mendoj se është koha për një reflektim dhe një qasje tjetër në dialogun dhe në zgjidhjen e këtij konflikti të ngrirë. Jo më nga poshtë-lart, sikurse zgjidhja e

problemeve teknike, për shembull targat e makinave apo të tjera si këto, por një zgjidhje që duhet të vijë nga lart-poshtë, që do të thotë që të dy vendet duhet ta njohin njëri-tjetrin si shtete të pavarura. Ne kemi parë që formula e ndjekur deri tani dhe me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian nuk ka funksionuar, për fat të keq. Dhe është krejtësisht e natyrshme që të pyesim se pse edhe 25 vjet pas mbarimit të luftës kemi ende një situatë të tillë kur në dialog janë diskutuar çështje krejtësisht teknike, të dobishme, por që gjithmonë janë teknike. Supozoni sikur një çerek shekulli pas përfundimit të luftës mes Gjermanisë dhe Francës gjatë Luftës së Dytë Botërore, Parisi dhe Berlioni të diskutonin se me çfarë targash makinash do të futeshin qytetarët e dy vendeve të njëri-tjetri. Pra besoj që ka ardhur koha për një reflektim, dhe një qasje tjetër në dialog në zgjidhjen e konfliktit të ngrirë, gjë që kërkon angazhimin e BE-së, por në mënyrë të veçantë atë të Shteteve të Bashkuara", ka thënë ai.

Rakipi foli edhe mbi alarmin e



dhënë së fundmi nga Departamenti Amerikan i Shtetit se Rusia po kërkon t'i shfrytëzojë tensionet ndëretnike në rajonin e Ballkanit Perëndimor për të

krijuar destabilitet. Kjo për ekspertin nuk është një gjë e re, por që sigurisht duhet të jetë një alarm i madh për udhëheqësit politikë të Ballkanit.

Rakipi ndodhej në Uashington për të marrë pjesë në Forumin Publik të NATO-s, një aktivitet që u mbajt në kuadër të takimit të nivelit të lartë të aleancës.

Kurti me ofertë për mërgimtarët që duan të investojnë në Kosovë



Prishtinë, 14 korrik - Kryeministri i vendit, Albin Kurti, të dielën i ka ftuar mërgimtarët të investojnë në Kosovë. Në platformën "Facebook", Kurti tha se këtë vit për bashkatdhetarët përfshihet edhe një dritare garantuese kreditore. Sipas tij, përmes saj do të garantojmë huat e bizneseve me pronarë nga mërgata që duan të kthehen e të investojnë në vendlindjen e tyre. "Përpos mbulimit të shpenzimeve të policës së sigurimit për automjete me vlefshmëri për një muaj,

pakoja jonë mirëseardhëse për bashkatdhetarët tanë këtë vit përfshin edhe një dritare garantuese kreditore, të cilën do ta hapim javën që po vjen. Përmes saj do t'i garantojmë huat e bizneseve me pronarë nga mërgata që duan të kthehen e të investojnë në vendlindjen e tyre, në republikën tonë. Këtë po e bëjmë me bindjen e plotë që potenciali i rritjes së vendit tonë dhe fuqia investuese e mërgatës sonë duhet të ecin krah për krah. Mirë se vini!", ka shkruar Kurti.

Hoxhaj: Kriminelët serbë nga veriu i Kosovës, të përfshirë në planet e vrasjes së Gjukanoviqit

PRISHTINË, 14 KORRIK - Ish-ministri i Jashtëm i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë se paraushtarakët dhe kriminelët serbë nga veriu i Kosovës, janë të përfshirë në planet e vrasjes së Milo Gjukanoviqit. Kështu ka

shkruar nënkryetari i Kuvendit, deputet i PDK-së, Enver Hoxhaj, në rrjetin social "X". "Paraushtarakët dhe kriminelët serbë nga veriu i Kosovës luajtën një rol vendimtar në tentativën për grusht-shtet në vitin 2016 kundër

presidentit Milo Djukanoviq dhe tani janë të përfshirë në planet e vrasjes kundër tij. Këto ngjarje janë të ndërlidhura, duke përfshirë Beogradin dhe Moskën, duke synuar hegjemoninë mbi Malin e Zi", ka shkruar Hoxhaj.





AUTORITETET AMERIKANE PO TENTOJNË TA ZBULOJNË MOTIVIN E ATENTATIT NDAJ ISH-PRESIDENTIT TË SHBA-SË, DONALD TRUMP

Trumpi i shpëton atentatit

Ish-presidenti i ShBA-së dhe kandidati i pritur republikan në zgjedhjet presidenciale të nëntorit, Donald Trump, i ka shpëtuar një atentati në një tubim në Pensilvani pas disa të shtënave me armë. Në një video, e cila qarkulloi menjëherë pas atentatit, Trumpi vendos dorën në veshin e djathtë dhe më pas shërbimet sekrete ndërhyjnë duke e shtrirë në tokë dhe duke iu hedhur sipër. Trumpi më pas çohet në këmbë me katër anëtarë të shërbimeve sekrete, të cilët e rrethojnë atë dhe, në shenjë demonstrative, i gjakosur në pjesën e djathtë të fytyrës, ish-presidenti amerikan ngre grushtin lart, duke përjetësuar një shkrepje, e cila bëhet menjëherë faqe e parë e medie botërore, me titull "Trumpi u shpëton të shtënave në Pennsylvania". Agjentët amerikanë e kanë vrarë sulmuesin në vendngjarje

tjerë u plagosën rëndë. Agjentët e kanë vrarë sulmuesin në vendngjarje, bëri me dije Shërbimi Sekret amerikan. Trumpi tha se u qëllua me një plumb që i shpoi pjesën e sipërme të veshit të djathtë. "E kuptova menjëherë se diçka nuk po shkonte kur dëgjova krisma, të shtëna, dhe menjëherë ndjeva se plumbi po çante nëpër lëkurë", shkroi Trumpi në llogarinë "Truth Social". Me të dëgjuar të shtënat, agjentët e Shërbimit Sekret e tërhoqën ish-presidentin amerikan nga skena dhe e larguan me një automjet që e priste.

Trumpi, përmes një postimi në "Truth Social", tha të dielën se mezi pret të flasë në Uiskonsin, ku javën e ardhshme do të mbahet Kuvendi Kombëtar i Partisë Republikane. "Në këtë moment është më e rëndësishme se kurrë që të jemi të bashkuar dhe ta tregojmë karakterin e vërtetë si amerikanë, duke qëndruar të fortë dhe të vendosur", shkroi ai. Ky është postimi i dytë që ai ka

bërë që kur u qëllua në vesh një ditë më parë në Pensilvani.

Shërbimi Sekret amerikan tha se po heton se si sulmuesi, i armatosur me një pushkë të stilit automatik, mundi që të afrohej mjaftueshëm sa për të shtënë dhe për ta plagosur Trumpin.

Sulmuesi, që u vra nga agjentët, qëlloi disa plumba drejt skenës "nga një pozicion i lartë jashtë vendit ku u mbajt tubimi", tha Shërbimi Sekret.

Trumpi, që u pa i gjakosur tek u largua nga skena, mori mjekim në Pensilvani para se të nisej në klubin e tij të golfit në Nju-Xhersi.

Liderët nga e mbarë bota e kanë dënuar fuqishëm tentim-vrasjen ndaj Trumpit.

Presidenti amerikan Joe Biden deklaroi të shtunën, pas të shtënave, se është mirënjohës që merr vesh se Trumpi është mirë. "Lutem për të dhe familjen e tij dhe për të gjithë ata që ishin në tubim, ndërsa presim informacione të mëtejshme. Ne nuk mund të lejojmë që kjo të ndodhë. Ne

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 14 KORRIK - Byroja Federale amerikane e Hetimit (FBI) ka identifikuar Thomas Matthew Crooks, 20 vjeç, nga Bethel Park i Pensilvanisë, si subjektin e përfshirë në atentatin kundër ish-presidentit amerikan Donald Trump. Autoritetet amerikane po tentojnë ta zbulojnë motivin e këtij atentati.

FBI-ja tha më 14 korrik se hetimi për këtë çështje është duke vazhduar. FBI-ja e ka

cilësuar të shtënë në mitingun e ish-presidentit Donald Trump në mbrëmjen e së shtunës, një tentativë për vrasje. "Këtë mbrëmje ne patëm atë që ne e quajmë një atentat kundër ish-presidentit tonë Donald Trump. Është ende një skenë aktive krimi", tha Kevin Rojek, agjenti special i ngarkuar me zyrën në terren të FBI-së në Pittsburgh, duke folur në një konferencë shtypi në Butler, Pensilvani.

Sipas të dhënave, sulmuesi i dyshuar ishte i regjistruar si votues republikan në Pensilvani. Por, sipas raporteve

federale financiare të fushatave zgjedhore, ai, po ashtu, kishte dhënë 15 dollarë donacion për një komitet politik progresiv më 20 janar 2021, në ditën kur presidenti Joe Biden bëri betimin.

Kandidati i pritur republikan për president të ShBA-së, Trump, është jashtë rrezikut për jetë pas të shtënave me armë zjarri që ndodhën teksa ai fliste në një tubim në Pensilvani më 13 korrik.

Shërbimi Sekret amerikan tha se një person, që ishte në audiencë, është vrarë dhe dy të

nuk mund të jemi kështu. Ne nuk mund ta pranojmë këtë”, shtoi ai.

Shtëpia e Bardhë tha se Bideni, që po garon kundër Trumpit në zgjedhjet presidenciale, ka folur me të disa orë pas të shtënave.

Të shtënat në Pensilvani ndodhën vetëm dy ditë parë se të nisë Kuvendi Kombëtar i Partisë Republikane, ku Trumpi, 78 vjeç, pritet ta sigurojë nominimin e partisë për të garuar në zgjedhjet presidenciale të 5 nëntorit.

Kosova reagon për atentatin ndaj Trumpit

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka reaguar pas atentatit ndaj ish-presidentit amerikan Donald Trump. Osmani në platformën “X” ka shkruar se çdo lloj dhune politike kudo është e papranueshme dhe e dënojme ashpër atë. “Ne qëndrojmë në solidaritet të plotë me ish-presidentin Donald Trump, familjen e tij dhe të gjithë amerikanët e prekur nga të shtënat në mitingun e Pensilvanisë. Çdo lloj dhune politike kudo është absolutisht e papranueshme dhe ne e dënojme ashpër atë”, ka shkruar Osmani.

Kryeparlamentari Glauk Konjufca ka thënë se u shokuan me pamjet e atentatit ndaj ish-presidentit Trump. “Ky atentat është një sulm ndaj demokracisë dhe pluralizmit politik. Falë Zotit dhe institucioneve të sigurisë, presidenti Trump i shpëtoi këtij sulmi, ndërsa Amerika sot ka nevojë për bashkim rreth vlerave të saj fundamentale të lirisë qytetare dhe politike. Populli i Kosovës qëndron pranë popullit amerikan në çdo rrethanë e përballë çdo sfide që synon ta cenojë”, ka shkruar Konjufca në “Facebook”.

Kryeministri Albin Kurti në një reagim në platformën “X” ka shkruar se bashkohet me liderët e tjerë botërorë në dënimin e atentatit ndaj Trumpit. “Unë bashkohem me liderët e tjerë botërorë në dënimin e atentatit

Atentati ndaj Trumpit, Nesho: Fushata ka përfunduar, kandidati republikan drejt konfirmimit si president

Ish-ambasadori i Shqipërisë në Amerikë, Agim Nesho, e cilësoi një ngjarje të neveritshme atentatin ndaj Donald Trump. Ai tha se një ngjarje e tillë ka efekte në të gjithë botën, duke e ditur rolin e ShBA-së në ruajtjen e ekuilibrave kudo në botë.

Nesho tha se kemi një polarizim të tejskajshëm në jetën politike në ShBA.

Në një intervistë për News24,

Nesho tha se kjo ngjarje do të ketë një efekt të jashtëzakonshëm në zgjedhjet presidenciale të ShBA-së. “Fushata, për mendimin tim, pothuajse ka përfunduar. Kemi një lider që qëndron te parimet e tij, që është drejt finishit, që është vështirë të pengohet”, tha Nesho, duke iu referuar Donald Trumpit. Ai tha se pas këtij atentati do të kemi një unifikim të plotë jo

vetëm të republikanëve, por edhe elektoratit gri rreth kandidaturës së Trumpit.

Nesho tha se tashmë Trumpi do të shihet si një hero nga shumica e republikanëve.

Ai tha se Donald Trumpi ka një politikë konkrete që prek direkt elektoratin amerikan dhe premtori rikthimin e fuqishëm të ShBA-së dhe mbrojtjen e interesave të saj.



të tmerrshëm kundër ish-presidentit amerikan Donald Trump. I uroj shërim të plotë dhe të shpejtë atij dhe të tjerëve të plagosur dhe i dërgoj ngushëllimet e mia të sinqerta familjes së spektatorit të vrarë”, ka shkruar Kurti.

Kurti ka shtuar se mosmarrëveshjet politike në një demokraci duhet të shprehen gjithmonë përmes formave paqësore të fjalës dhe protestës

dhe të zgjidhen me zgjedhje të lira dhe të ndershme, pa përjashtime.

Për atentatin ndaj ish-presidentit Trump kanë reaguar edhe liderët e opozitës.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se është thellësisht i tronditur nga atentati ndaj ish-presidentit Donald Trump gjatë tubimit të tij zgjedhor në Butler të shtetit Pennsylvania. Sipas tij, akte të

tilla të dhunës janë të papranueshme dhe paraqesin sulm direkt ndaj demokracisë. “Në emrin tim dhe të Partisë Demokratike të Kosovës, e dënojme ashpër këtë sulm dhe solidarizohemi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në këto momente shqetësuese. Mendimet dhe lutjet tona janë me ish-presidentin Trump, familjen e tij dhe popullin amerikan. Urojmë që ish-

presidenti Trump të rikuperohet shpejt nga ky sulm i rëndë ndaj tij dhe t’u rikthehet aktiviteteve të fushatës zgjedhore. Kosova dhe qytetarët tanë mbeten të palëkundur në mbështetjen tonë për Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, ka shkruar Krasniqi në rrjetet sociale.

Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka reaguar pas atentatit ndaj ish-presidentit të ShBA-së, Donald Trump. Ai ka thënë se janë tronditur nga ky atentat, duke i uruar shërim të shpejtë ish-presidentit Trump. “Të tronditur nga akti i sotëm i dhunës ndaj ish-presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z. Donald Trump, unë dhe Lidhja Demokratike e Kosovës shprehim indinjatën dhe zemërimin ndaj një veprimi të tillë. Njëkohësisht, i qëndrojmë afër në lutje z. Trump dhe familjes së tij si dhe i urojmë shërim të shpejtë dhe kthim në aktivitetet e tij të përditshme, në të mirë të përparimit të demokracisë. Aktet e tilla duhet të na shërbejnë si moment reflektimi dhe zotimi për luftimin e dhunës të cilësdo natyre ajo qoftë dhe forcimin e bashkëpunimit dhe lirisë, si themele për zhvillimin e demokracisë”, është thënë në deklaratën e Abdixhikut.

Po ashtu, atentatin ndaj Trumpit e ka dënuar edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. “Aktet e dhunshme janë një pengesë për realizimin e demokracive, janë të papranueshme dhe duhet të ndalohen. ShBA-ja është një shembull për demokracitë në të gjithë botën dhe së bashku ne përparojmë përmes diskursit paqësor të vendeve tona dhe respektit për sundimin e ligjit. I uroj presidentit Trump shërim të plotë!”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.



Sulmohet me koktej molotovi një lokal në veri që Sveçla e kishte vizituar

MITROVICË E VERIUT, 14 KORRIK - Pasticëria "Sharr" në Mitrovicë të Veriut është sulmuar me koktej molotovi mëngjesin e 14 korrikut.

Lajmi u konfirmua për "Radion Evropa e Lirë" nga zëvendësudrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani. "Rreth orësh 03:30 ka pasur tentim për zjarrvënie në Mitrovicë të Veriut", tha Elshani. Sipas tij, dëmet materiale janë të vogla. "Për momentin nuk kemi të dyshuar", theksoi Elshani.

Ditë më parë ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, së bashku me

ish-kryetarin e Mitrovicës së Jugut, Agim Bahtiri, kishin qëndruar në pasticërinë që u bë cak i sulmit me koktej molotovi më 14 korrik. Pronarët e lokalit janë pjesëtarët të komunitetit goran. I pyetur nëse sulmi ndaj këtij lokali u krye në shenjë hakmarrjeje për vizitën e Sveçlës, Elshani tha se "nuk përjashtohet" mundësia që ky të jetë motivi i sulmit.

Tensionet në veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe, janë të larta që nga viti i kaluar, kur mes kundërshtimeve të popullatës lokale serbe, kryetarët shqiptarë morën

drejtimin e Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut.

Tensionet u rritën edhe më shumë më 24 shtator, pasi një grup i serbëve të armatosur sulmuan Policinë e Kosovës në Banjaskë të Zveçanit, duke vrarë një rreshter. Gjatë përleshjeve që pasuan u vranë edhe tre sulmues serbë.

Kosova fajëson Serbinë për sulmin, por Beogradi mohon përfshirjen. Përgjegjësinë për sulmin e armatosur në Banjaskë e ka marrë Millan Radoičiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve në Kosovë që gëzon



mbështetjen e Beogradit. Kosova ka kërkuar që Serbia ta dorëzojë Radoičiqin dhe

pjesëtarët e grupit të tij që kryen sulmin para autoriteteve gjyqësore të Kosovës.

Luledielli mbulon tokat e Kosovës

PRISHTINË, 14 KORRIK - Rritja e subvencioneve në bujqësi ka ndikuar që shumë kosovarë t'i kthehen mbjelljes së kulturave të ndryshme bujqësore. Një nga ta është edhe Shukri Sallahu nga fshati Zllatar i komunës së Ferizajt. Ky është viti i pestë që ai kultivon lulediellin dhe çdo vit ka rritur gradualisht sipërfaqen e mbjellë.

Sivjet ai ka mbjellë rreth 53 hektarë me luledielli dhe pret rendiment të lartë. "Pres ta kem një rendiment shumë të mirë. Siç i ka parametrat deri më tani luledielli, deri në fund të gushtit do ta korr", shprehet Sallahu.

Luledielli është një bimë njëvjeçare

dhe përdoret kryesisht për prodhimin e vajit për gatim. Kjo bimë, siç thotë ai, është e lehtë për t'u kultivuar dhe varësisht nga kushtet atmosferike, sipas tij, mund të jetë edhe profitabile. "Gjithherë jam ndarë i kënaqur me këtë bimë. Sivjet jam më i kënaqur sepse është në gjendje shumë të mirë", thotë Sallahu.

Ditë më parë ministri i Bujqësisë, Faton Peci, njoftoi se ky vit po shënon rekorde për rendimente pothuajse në çdo kulturë bujqësore, me theks të veçantë drithërat. Ai shkroi në "Facebook" se përmes përcaktimit të produkteve strategjike, qeveria ka rritur

mbështetjen financiare për kulturën e lulediellit në 454 euro për hektar.

I kënaqur me subvencionimin e lulediellit shprehet edhe Shukri Sallahu. "Jam i kënaqur me subvencionimin që marr nga shteti. Thuajse na i mbulon të gjitha shpenzimet që i kemi përfshirë farën, naftën dhe plehun", thotë Sallahu.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, subvencionimi ka ndikuar që sipërfaqet e mbjella me luledielli të rriten nga rreth 45 hektarë sa ishin në vitin 2022 në mbi 1 000 hektarë këtë vit. Kjo, sipas kësaj ministrie, paraqet rritje për më

shumë se 24 herë. Por, kultivimi i lulediellit do të ishte më profitabil sikur Kosova të kishte industri të zhvilluar të prodhimit të vajit, thotë Sallahu.

Aktualisht, ai thotë se të gjithë prodhimin e eksporton në vendet e rajonit.

Me gjithë subvencionimin, jo gjithmonë mbulohen shpenzimet e bujqve pasi, siç thotë Sallahu, ata mund të përballen me telashe, përfshirë kushtet atmosferike, prishjet e makinerisë e të tjera.

Ndonëse më shumë kosovarë janë duke e kultivuar lulediellin si kulturë, shitjen e këtij produkti ata kryesisht e bëjnë jashtë vendit.

Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës tregojnë se Kosova ka mbi 512 mijë hektarë tokë të përshtatshme për bujqësi, por për qëllime të ndryshme shfrytëzohen rreth 420 mijë hektarë. Sipas ASK-së, rreth 189 mijë hektarë shfrytëzohen për rritjen e kulturave bujqësore, mbi 217 mijë hektarë hyjnë në kategorinë e livadheve dhe kullotave, ndërsa sipërfaqet e tjera janë plantacione për pemë, perime dhe kopshte.

Kosova prej vitesh përballlet me deficit të lartë tregtar, që do të thotë se importon më shumë sesa eksporton, përfshirë këtu edhe prodhime bujqësore.



Raportet e Auditorit, Ramadani: Shumë ministra e deputetë do të përfundojnë në burgje

PRISHTINË, 14 KORRIK - Ish-inspektori i AKI-së, njëherësh njohës i çështjeve të sigurisë, Burim Ramadani, referuar gjetjeve të shumta në Raportet të Auditorit, thotë se po zbardhen keqpërdorime të shumta, për çka parashikoi se Prokuroria do të ketë "shumë punë" nëpër ministri dhe institucione të tjera. "Këta që

po arratisen nga burgjet, jam i bindur që po ua lënë vendet shumë prej ministrave, deputetëve dhe militantëve nëpër institucione. Shumë keqpërdorime po dëshmojnë Raportet e Auditorit, të publikuara në qershor 2024. Sipas këtyre raporteve, po besoj se shumë punë paska Prokuroria nëpër ministritë

dhe institucionet e tjera. Këta që po arratisen nga burgjet, jam i bindur që po ua lënë vendet shumë prej ministrave, deputetëve dhe militantëve nëpër institucione. Një analizë të detajshme për gjetjet e auditorit së shpejti, me shumë shpjegime se çka nënkuptojnë ato gjetje", shkruan Ramadani në "Facebook".



Rreth 800 gjoba janë shqiptuar për gjashtë muaj nga Inspektorati i Punës

Prishtinë, 14 korrik - Rreth 800 gjoba janë shqiptuar për gjashtë muaj nga Inspektorati i Punës. Shkelësit më të mëdhenj të ligjit janë nga sektori i ndërtimit dhe i marketeve.

Shkëputje e kontratës, moskompensim i orëve jashtë orarit e gjatë festave, mungesë e sigurisë e shëndetit në punë, këto janë disa nga shkeljet e të drejtave të punëtorit që janë evidentuar në këta sektorë të ndëshkuar nga Inspektorati. Kryeinspektori i Punës,

Hekuran Nikçi, në intervistën për "KosovaPress", thotë se nga janari deri në qershor kanë realizuar mbi 5 900 inspektime. Po ashtu, deklaruar se gjatë këtij viti ka vdekur një person në vend të punës si pasojë e kushteve të punës. Ai thotë se mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve ka për qëllim vetëdijesimin e subjekteve. "Për periudhën janar - qershor të këtij viti, Inspektorati i Punës ka realizuar në total 5 960 inspektime, apo 2 285

inspektime më shumë sesa në vitin 2023. Gjatë kësaj periudhe janar - qershor të këtij viti ka shqiptuar 787 masa ndëshkimore apo gjoba, që i bie 385 masa ndëshkimore më shumë se vitin e kaluar. Masat ndëshkimore shqiptohen në subjekte juridike të cilat shkelin dispozitat ligjore të Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë, Ligjit të Punës dhe çdo ligj tjetër që mbikëqyrim zbatimin e tij", ka deklaruar Nikçi.



Punësimi në Kosovë, statistika të manipuluar apo reale?

PRISHTINË, 14 KORRIK - Gati 700 mijë qytetarë në moshë pune janë joaktivë (nuk punojnë as nuk kërkojnë punë), nga ta mbi 100 mijë të rinj as nuk punojnë, as nuk janë në shkollë e as në trajnime. Kështu shkalla e joaktivitetit vazhdon të mbetet mjaft e lartë, rreth 60 për qind.

Përkundër kësaj, ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati mburret me numrin e llogarive aktive me mbi 400 mijë në Trust për vitin 2023. Për këtë, opozita dhe ish-ministri i Financave, Haki Shatri, thonë se pushteti po mundohet t'i mashtrorë qytetarët dhe të krijojë manipulim shifrash. Sipas Shatrit, numri real i të punësuarave është 370 mijë, raporton "KosovaPress". Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore për Tremujorin e tretë të vitit 2023 tregojnë se rreth dy të tretat e popullsisë në Kosovë, 1 milion e 180 mijë e 450 banorë janë popullsi në moshë pune, ku persona joaktivë ishin 697 mijë e 191 qytetarë, derisa persona të punësuar ishin 432 mijë e 40. "Shkalla e joaktivitetit vazhdon të mbetet mjaft e lartë, 59.1 për qind. Shkalla e joaktivitetit të femrat ishte shumë e theksuar me 75.2 për qind, krahasuar me meshkujt 42 për qind. Të rinjtë që nuk janë të punësuar nuk ndjekin shkollimin ose trajnimin janë 103



mijë e 35", thuhet në raportin e Anketës së Fuqisë Punëtore për TM3 2023 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Më tej, sipas të dhënave zyrtare të ASK-së, thuhet se të punësuar në vitin 2022 kanë qenë 403 mijë e 813 qytetarë nga mosha 15-64. Në

vitin 2017 kanë qenë të punësuar 357 mijë e 95 qytetarë, ndërsa në vitin 2014 ishin 323 mijë e 508.

Sipas të dhënave zyrtare në Trustit, në vitin 2023 kanë qenë 442 mijë e 383 llogari aktive, më 2022 ishin 428 mijë e 891, në vitin 2017 kanë qenë 352 mijë 849

qytetarë dhe në vitin 2014 ishin 285 mijë e 914 llogari aktive.

Ditë më parë ministri i Financave, Hekuran Murati, shkroi se numri i llogarive aktive në vitin 2023, pra llogarive aktive në Trust, ka qenë 442 mijë e 383, duke shtuar se me këto shifra po demantojnë

opozitën.

Për dallim nga pushteti, opozita konsideron se Ministria e Financave ka përdorur statistikat nga situatat kur ka subvencionuar përkohësisht, në të cilat qytetarët kanë qenë të obliguar që për një periudhë të regjistrohen për t'i marrë subvencionet.

Deputeti nga Partia Demokratike e Kosovës, Ferat Shala, thotë se kjo ministri po vazhdon të luajë me shifra dhe numra.

Edhe deputeti nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Pal Lekaj, thotë se kjo qeveri po mundohet t'i mashtrorë qytetarët me statistika joreale.

Ish-ministri i Financave, Haki Shatri, vlerëson se qeveria po manipulon opinionin me shifra.

Ndërkaq kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, konsideron se kjo situatë nga Ministria e Financave nuk është për mburrje. Sipas tij, krekosja duhet të ndodhë kur të ulet në minimumin e mundshëm papunësia.

Deputeti nga partia në pushtet, Armend Muja, thotë për KosovaPress se jo të gjitha llogaritë aktive në Trust janë vende të reja të punës. Sipas tij, që nga koha e pandemisë deri në raportin e fundit të ASK-së janë rreth 100 mijë të cilët janë riaktivizuar në tregun e punës.

Kurti vizitoi Qendrën e Turizmit në Pejë, 150 mijë turistë vizituan Pejën në 2023-n

PEJË, 14 KORRIK - Kryeministri Albin Kurti ka vizituar qendrën e turizmit në Pejë. Atje kryeministri pati mundësinë ta vizitojë nga afër projektin "Turizmi i aventurës", vlera totale e të cilit arrin në 262 mijë euro, prej të cilave 165 mijë euro nga qeveria përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 97 mijë euro nga komuna e Pejës.

Zyra e turizmit tashmë është rinovuar, ndërsa për zhvillimin e sektorit në këtë zonë po vazhdon puna në vendosjen e vijave të ngjites, infrastrukturës përcjellëse, pushimoreve në shtigjet

malore dhe shenjëzimin e shtigjeve. Ndërkohë nga buxheti i MAPL-së dhe projektit Demos, në komunën e Pejës për vitet 2021-2024 janë financuar gjithsej 41 projekte në vlerë prej 3.3 milionë eurosh.

Gjatë vizitës kryeministri Kurti u takua dhe me përfituesit e projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar Kosovë - Mali i Zi, të cilat po zbatohen në kuadër të investimeve të fondeve IPA nga Bashkimi Evropian dhe programit të BNK-së Kosovë - Mali i Zi.

Në total janë gjithsej 11 projekte që prekin vlerën prej 4

296 905 eurosh. Përfitues nga këto projekte janë komuna Peja, Istogu, Juniku, Deçani, Klina dhe Gjakova, ndërsa nga Mali i Zi, ndër shumë komuna, janë edhe ato të Rozhajës, Tuzit, Ulqinit, Kolashinit e Plavës.

Kryeministri Kurti theksoi rëndësinë e këtyre projekteve për zhvillimin e turizmit, por edhe forcimin e bashkëpunimit bilateral mes dy shteteve tona. "Bukuritë e pasuritë natyrore të Pejës janë mahnitëse e rrëzëlluese. 150 mijë vizitorë u regjistruan në vitin 2023, me mesatarisht 4 ditë qëndrimi për turist në Pejë", ka njoftuar Kurti.



Trajnimet për sigurinë në punë, për disa të padëgjjuara



Nga Marco BRUNA,
Corriere della Sera

Disa rrëfime, që i atribuohen orientimeve politike të majta dhe të shqyrtuara nga Washington Post, kanë ngritur alarmin dhe kanë folur për një "false flag operation". Lajmet e rreme përfshijnë gjithashtu edhe një italian.

Kush e di se çfarë do të kishte ndodhur më 22 nëntor 1963, ditën e vrasjes së John Fitzgerald Kennedy, nëse rrjetet sociale do të kishin ekzistuar. Është e natyrshme ta pyesim veten për këtë, pasi konsultohemi me internetin, në një vazhdimësi të menjëhershme të teorive konspirative dhe dezinformative të lidhura me sulmin e pësuar nga Donald Trump, gjatë një mitingu në Pensilvani në pasditen e 13 korrikut (natën vonë në

Shqipëri).

Se bëhej fjalë për një atentat në tentativë u sqarua nga policia dhe pas kontrolleve fillestare edhe nga shtypi amerikan. FBI ka qarkulluar dhe ka konfirmuar identitetin e sulmuesit, njëzet vjeçarin Thomas Matthew Crooks.

Disa rrëfime, që i atribuohen orientimeve politike të krahut të majtë dhe të shqyrtuara nga Washington Post, flisin për një "false flag operation", një operacion i studiuar nga mbështetësit e Trump. Që do të thotë se kjo synon ta bëjë ish-presidentin dhe kandidatin republikan për Shtëpinë e Bardhë të duket si martir duke përdorur një gjest ekstrem siç është sulmi.

Në anën e kundërt, në të djathtë, ka nga ata që përkundrazi kanë vënë në dukje Joe Biden si "nxitës" të atentatit në tentativë për të fituar një avantazh politik, tani

që ai ka mbetur prapa në sondazhe. Ajo që po rindez teoritë më ekstreme të konspiracionit, pretendojnë disa ekspertë të cituar nga gazeta amerikane, është klima e polarizimit që ka zënë rrënjë brenda vendit dhe që po shtyn një segment të shoqërisë të përqafojë "realitetet alternative" (fjalë me të cilën ne kanë filluar të njihen me presidencën e Trump).

Një nga hashtags që u shfaq në X sot ishte #stage, për të nënvizuar se si ishte një ngjarje e inskenuar, e inxhinieruar. Burimet e këtyre teorive janë, si gjithmonë në këto raste, të dyshimta.

Veshi dhe fytyra e përgjakur e Trump ndezi si ndikuesit e krahut të djathtë, ashtu edhe disa përfaqësues të partisë republikane. Mike Collins, një anëtar i krahut të djathtë të Kongresit - një politikan që prezantohet në biografinë e tij

me porosi" dhe se është një "nxitje për të vvarë". Media sociale X është një nga vendet ku lajmet e rreme qarkullojnë më shpejt, së bashku me Truth dhe Parler, të preferuarit e bazës republikane. Vetë Elon Musk, njihet si një mbështetës i së djathtës.

Në TikTok, një llogari e quajtur @theoldermillennial.1, e ndjekur nga mbi një milion njerëz, shkon më tej: «Meqenëse çështjet gjyqësore të Trump nuk po shkonin aq mirë, ata vendosën (demokratët, red.) të provonin një rrugë tjetër. Djema, mos harroni, kjo është ajo që e majta është në gjendje të bëjë». Natyrisht, ne gjithashtu kthehemi të flasim për Deep State që ndikon dhe dikton axhendën politike të një vendi, fuqinë e nëndheshme që qytetarët nuk e shohin: përsëri në X, një llogari anonime por e verifikuar (Hija e Ezrës) shkruan se "The Deep State

tentoi të vriste Donald Trumpin drejtpërdrejt në televizion".

Marjorie Taylor Greene, figurë e diskutueshme e republikanëve (në vitin 2022 ajo u bë anëtarja e parë e Kongresit të SHBA që iu bllokua llogaria e saj personale në Twitter për përhapjen e dezinformative në lidhje me Covid-in) nuk la gjë pa thënë për shtypin "komunist" i cili nuk foli menjëherë. Ajo këmbëngul në pikën që demokratët dhe Joe Biden duan të heqin qafe rivalin e tyre politik në çdo mënyrë.

Në rrjetet sociale ka edhe pretendime se sulmuesi ishte një anëtar i së majtës ekstreme, i lëvizjes militante Antifa: Mark Violets, i cili në fakt është gazetari i paditur italian Marco Viola. Asnjë nga postimet e shqyrtuara nga gazetaret kryesore amerikane, duke përfshirë New York Times, nuk dha prova që vërtetonin vërtetësinë e pretendimeve të tyre.

Dyshimet dhe polemikat për sigurinë pas sulmit ndaj Trump: Raportuam snajperin, pse nuk e ndaluan?



Nga Guido OLIMPIO,
Corriere della Sera

Si mund të rrinte Thomas Matthew Crooks në një çati disa qindra metra larg tubimit të një ish-presidenti të Shteteve të Bashkuara, i pashqetësuar? Pse nuk u ndalua? Si mundi Thomas Matthew Crooks, 20-vjeçari që tentoi të vrasë Donald Trump, të pozicionohej i patrazuar në një çati disa qindra metra larg tubimit të ish-presidentit amerikan? Pse nuk u ndal, pavarësisht se disa video e shfaqin qartë atë duke marrë në shenjë para se të qëllonte?

Këto janë disa nga pyetjet që autoritetet do të përpiqen t'i përgjigjen në orët në vijim – e para pas sulmit ndaj kandidatit republikan për Shtëpinë e Bardhë. Ja analiza e firmosur nga Guido Olimpio.

Katër rrathët e një sulmi, një veprim me një objekt primar në qendër: Donald Trump.

Rrethi i parë: para ngjarjes

E para. Shërbimi Sekret ka detyrën e vështirë për të mbrojtur presidentin, zonjën e parë dhe disa personalitete, përfshirë edhe kandidatit sfidues. Të gjithëve u është caktuar një emër i koduar: "Celtic" - në të kaluarën - për Biden, "Pioneer" për Kamala

Harris dhe "Mogul" i rezervuar për Trump. Nuk e dimë nëse janë emrat aktualë. Mbrojtja fillon shumë përpara një ngjarjeje publike, si p.sh. një tubim apo turmë. Vlerësohen kërcënimet, studiohet prania e elementëve potencialisht të rrezikshëm në zonë – ndoshta zbulohet sepse kanë postuar apo thënë diçka – ka një analizë teatri. Do të shohim nëse gjuajtësi kishte lëshuar ndonjë sinjal. Një hetim në të cilin hyri menjëherë FBI. Recently Spotted Asteroid Set for Near Miss With Earth Keep Watching

Rrethi i dytë: pse nuk u ndalua sulmuesi?

E dyta. Në zonën e takimit, Shërbimi Sekret vendos gjithmonë ekipin e Kundër Snajperit (për t'iu përgjigjur një snajperi), ekipin e Kundër Sulmit (për të kundërshtuar një rrezik edhe më të madh) dhe një mori truprojesh. Orët e fundit janë ngritur polemika për mungesën e vëzhgimit të zonës përreth podiumit. Shumë ekspertë - ish-zyrtarë - nënvizuan se ishte i nevojshëm një zbulim i kujdesshëm i ndërtesave pranë podiumit, pasi ato përfaqësonin një pikë të dukshme qitjeje. Më tej, "teatri" i pritës është i rrethuar vetëm nga disa struktura apo magazina, ndaj verifikimi kërkonte forca të kufizuara. Një

zonë urbane me një sërë ndërtesash do të kishte qenë shumë ndryshe. Mbetet për t'u kuptuar nëse ka pasur mungesë koordinimi mes njësive vendore dhe Shërbimit Sekret. Nuk është ende e qartë se si sulmuesi arriti të hipte në çati pa u parë. Dikush nga turma e vuri re praninë e tij dhe do të kishte lajmëruar disa policë, por ishte vonë. CNN, sipas burimeve të informuara, raporton se i riu që qëlloi me armë zjarri ishte vënë re jashtë tubimit nga policia që e konsideroi të dyshimtë.

Një rindërtim grafik i bërë nga një vëzhgues në ueb tregoi gjithashtu se Matthew Crooks kishte një pamje të qartë dhe të favorshme, ndërsa vetëm një nga grupet e gjuajtësve të Shërbimit kishte një pozicion me një "horizont" të qartë (i dyti pengohej nga disa pemë). Siç raportohet nga agjencia Reuters, Ben Maser - një saldator 41-vjeçar - tha se ishte jashtë perimetrit të tubimit, duke dëgjuar Trump, kur vuri re dy agjentë që dukej se po kërkonin dikë. Në atë moment, edhe ai filloi të kontrollonte zonën. Një person i intervistuar nga BBC tha se ai pa personin e armatosur dhe u përpoq pa sukses të lajmëronte policinë dhe shërbimet sekrete. "Ne vumë re djaloshin duke u ngjitur në çatinë e ndërtesës pranë nesh, 15 metra larg", tha Greg Smith. "Ai kishte një pushkë, shihej qartë një pushkë. Ne po e tregonim atë, policia ishte aty dhe ne po thoshim: "Hej, burrë, është

një djalë në çati me pushkë"... dhe policia nuk e dinte se çfarë po ndodhte." Smith tha se ai u përpoq të lajmëronte autoritetet për tre ose katër minuta, por mendoi se ata ndoshta nuk mund ta shihnin personin e armatosur për shkak të pjerrësisë së çatisë. "Pse nuk ka shërbime sekrete në të gjitha këto çati?" "Nuk është një vend i madh. "Është një gabim sigurie, një gabim 100% sigurie." Disa burra nga ekipi Counter Sniper e angazhuan atë, duke e rvarë, por ndërkohë elementi "armiçësor" kishte hapur tashmë zjarr, duke shënjestruar Donaldin. Sulmuesi u neutralizua vonë.

Rrethi i tretë: evakuimi (i hutuar).

E treta. Agjentët e mbrojtën Trumpin dhe qëndruan në një rreth duke e përqaftuar. Pamjet e transmetuara në TV, në një moment të caktuar, e shfaqnin politikanin qartësisht të dukshëm dhe të pambuluar. Situata në rrezik nëse do të kishte pasur një sulmues të dytë të përzier mes kalimtarëve, disa metra larg. Akoma më keq nëse do të kishte hedhur një pajisje plasëse. Askush, përveç një agjenti i vetëm qëndronte përpara podiumit, i cili ishte i aksesueshëm për të paktën një fotograf. Evakuimi - vazhdojnë të theksojnë ekspertët - nuk ishte i shpejtë, herë pas here dukej i hutuar. Pamjet televizive

"dokumentuan" edhe lëvizjet e një shoqëruese e cila nuk mundi ta vendoste armën në këllëf.

Trump pas të shtënave

Rrethi i katërt: kohët e vështira të Shërbimit Sekret

Së katërti. Shërbimi Sekret "arriti" në këtë situatë pas periudhave të vështira dhe nën presidentë të ndryshëm. Kujtojmë ndërhyrësin brenda Shtëpisë së Bardhë, shkeljet e përsëritura të portave të rezidencës, stafin që përfundoi në telashe për sjellje të papërshtatshme për rolin dhe prestigjin e tyre. Që nga viti 2022, ai drejtohet nga Kimberly Chetley, një veterane me 28 vjet në shërbim dhe një stazh në Pepsi Cola. Ishte ajo që evakoi Dick Cheney-n në orët tragjike të 11 shtatorit 2001 dhe më vonë u kujdes për Joe Biden kur ai mbante postin e zëvendës-presidentit. Megjithatë, në krye të sektorit operacional është Cynthia Sjoberg Radway, një nga shumë gra që i janë bashkuar departamentit. Po flasim për një agjenci që ka burime, përdor mjete speciale (mendoni Bishën, limuzinën super të blinduar dhe kolonën që e ndjek), ka 150 degë dhe ka 7 mijë zyrtarë, por që nuk mund të përballojë të bëjë qoftë edhe një herë gabim. .

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON ENVERI
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

SPORT
EURO2024 GERMANY



Kosova, kampion në FIBA U-16 Kampionatin Evropian

PRISHTINË, 14 KORRIK - Kosova ka triumfuar në finalen e FIBA U-16 Kampionatit Evropian ndaj Shqipërisë me rezultat 61-101 (8:28,18:23,11:18,24:32). Që nga fillimi Kosova dha maksimumin e saj duke e nisur me super seri prej 0:9 e

duke e mbyllur pjesën e parë me epërsi të konsiderueshme prej 25 pikësh apo rezultat të përgjithshëm 26:51. Lufta për çdo top në çdo cep të fushës tregoi dëshirën e vërtetë të "Dardanëve" për këtë fitore. Ritëm i njëjtë vazhdoi edhe në

periudhat e fundit ku Kosova me epërsinë e krijuar po zbatonte lojën e saj pa asnjë problem. Në fund Kosova u shpall kampion e FIBA U-16 Kampionatit Evropian me rezultat 61:101. Tek Kosova shkëlqyen Besim Bytyqi me 22

pikë, 9 kërcime dhe 5 asistime si dhe Lis Binishi me 20 pikë, 10 kërcime dhe 6 asistime. Kosova e mbylli Kampionatin pa asnjë humbje ndërsa vitin e ardhshëm luan në një rang më lartë, në divizionin B për grup moshën U-16.



Spanja, kampione e Evropës

BERLIN, 14 KORRIK - Kombëtarja e Spanjës është kampione e re e Evropës në futboll, pasi në finalen e "Euro 2024" e mposhti Anglinë me rezultat 2-1. Gola, spektakël kishte në Berlin ku fituese doli "Furinë e Kuqe", ndërsa kupa mbetet makth për Anglinë, me ishullorët që dalin sërish duar bosh. Një finale nuk luhet, por fitohet, të vetëdijshëm për këtë, dy ekipet zbriten me respekt dhe frikë në fushë, mbi të gjitha Anglia, me "Tre Luanët" që e kishin të vështirë të ishin efikas. Nuk bëri më mirë as Spanja, sigurisht kishin kontrollin e topit, por Yamal e Nico Williams u bllokuan në krahë duke mos arritur dot as të depërtonin e as të shërbenin në zonë. Dy ekipet zhvilluan një pjesë të parë të luftuar për çdo top, në çdo cep të fushës, duke bërë që goditja e parë në kuadrat të vinte vetëm në minutën e 47-të me Phil Foden. Fraksioni i dytë krijoi iluzionin se gjërat do të shkonin në "malore" për De la Fuenten, me teknikun spanjoll që u

detyrua të bënte pa Rodrin, me mesfushorin që qëndroi në dhomat e zhveshjes si pasojë e një dëmtimi, por "furia e kuqe" e nisi "zjarr", ku në aksionin e parë, në topin e parë, Lamine Yamal dhuroi një super asistim për Nico Williams që nuk falë brenda në zonë duke dërguar topin në rrjetë. Goli trulloi Anglinë, ndërsa Southgate ndërhyri në formacion duke ulur në stol kapitenin Harry Kane për Watkins. Për t'i dhënë zemër "Tre Luanëve" mendoi Jude Bellingham, por goditja e yllit anglez përfundoi ngjitur me shtyllën pingule. Më Anglinë përpara, Yamal për pak i kapi "mat" në minutën e 67-të, por goditja e tij u devjua në këndore nga portieri Pickford. Me lëvizjen e dytë, Southgate bëri "bingo", teksa Palmer, i sapo hedhur në fushë, në minutën e 73-të, me një super goditje nga distanca barazoi shifrat në 1-1, duke rikthyer ishullorët në lojë. Atëherë kur gjithçka po shkonte drejt fundit, në minutën e



87-të, Cucurella futi një top perfekt në zonë, aty ku Oyarzabal gjeti preken fituese duke mposhtur

Pickford për herë të dytë, një gol me shije trofeu, pasi rezultati mbeti i pandryshuar deri në fund, me

Spanjën që bën poker trofesh duke u shpallur kampione Evropë për herë të katërt në histori.

Rexhbeçaj i bashkohet Kosovës



PRISHTINË, 14 KORRIK - Futbollisti i njohur, Elvis Rexhbeçaj, ka nënshkruar për Përfaqësuesen e Kosovës në prani të përfaqësuesit të Federatës së Futbollit të Kosovës për Gjermani, Fekmi Kongjeli (i cili ka mbajtur kontaktin me Elvisin), vëllait të tij Blendard Rexhbeçaj, i cili njëherësh është menaxheri i tij, si dhe biznesmenit Afrim Osmanaj. Letra konfirmuese u nënshkrua me presidentin e FFK-së, Agim Ademi, i cili u shpreh shumë i kënaqur me këtë prurje të re tek Dardanët. Ademi theksoi rëndësinë e këtij transferimi për Kombëtaren e Kosovës, duke vlerësuar lart profilin dhe aftësitë e

Rexhbeçaj, të cilat do të jenë një shtesë e çmuar për ekipin e drejtuar nga Franco Foda. Edhe vetë futbollisti, Elvis Rexhbeçaj, shprehu entuziazmin e tij për këtë vendim të rëndësishëm në karrierën e tij. Ai falënderoi familjen për mbështetjen e vazhdueshme, si dhe Agim Ademin dhe Fekmi Kongjelin, për përpjekjet dhe kontaktet e vazhdueshme ndër vite. "Sot i thash 'Po' Kosovës. Falënderoj në radhë të parë familjen time për përkrahje të vazhdueshme, falënderoj Agim Ademin si dhe Fekmi Kongjelin dhe gjithë FFK-në, që për shumë vite kanë

qëndruar në kontakt me mua. Pres me padurim të bashkohem me shokët e Kombëtares dhe t'i realizojmë ëndrrat tona. Unë deri më tani kisha pengesa ligjore për shkak të pasaportës së Kosovës. Tani me ligjin e ri që erdhi për lejimin e dy pasaportave vendosa me zemër t'i bashkohem Kosovës. Forca Dardanët!", është shprehur Rexhbeçaj. Kjo prurje e re është një hap i madh për Kosovën, duke shtuar një tjetër lojtar me përvojë dhe aftësi të larta. Tifozët Dardanët dhe gjithë komuniteti i futbollit presin me padurim paraqitjet e Rexhbeçaj në ndeshjet e ardhshme në Ligën e Kombeve.

Alcaraz gjunjëzon serbin Djokovic, fiton për herë të dytë radhazi Wimbledon

LONDËR, 14 KORRIK - Carlos Alcaraz ka shkatërruar tenistin me sjellje më të ndyrë në histori të këtij sporti, Novak Djokovic, për të triumfuar për herë të dytë në Wimbledon. Spanjollit ishte

dominues nga fillimi deri në fund, duke e bërë serbin të dukej si një amator. Alcaraz e fitoi setin e parë dhe të dytë me rezultat 6-2, ndërsa të tretin e mbylli me 7-6 (7-4). Tenisti 21-vjeçar tregoi që

shumë shpejt do të ketë dominim edhe më të madh në botën e këtij sporti, ndërsa parashikohet që të kalojë edhe legjendat Roger Federer dhe Rafael Nadal. Ky triumf nga Alcaraz i tregon serbit që

e përfshinë politikën në sport se ka ardhur fundi i tij dhe të kthehet për në Serbi. Kjo është hera e dytë që spanjollit e mposht këtë sportist në Wimbledon, pasi fitore kishte marrë edhe në vitin 2023.



Shënimet e Komitetit të Mbeturinave
për Kompaninë e Mbeturinave
për Uklanje Otpada
"PASTRIMI" sh.a.d.d.
Nr. 3477 dt. 12.09.2024
Prishtinë - Prishtinë



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "PASTRIMI" SH.A

Duke u bazuar në Ligjin Nr. Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës konkretisht Neni 8 Udhëzimin Administrativ MFPT Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik konkretisht Neni 5 Paragrafi 1,2 dhe Neni 7, Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, Vendimin e datës 12.07.2024 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK (Për plotësimin e vendit të punës)

Titulli i vendit të Punës: "Udhëheqës i Zyres për Burime Njerëzore" në KRM "Pastrimi" SH.A (1) pozitë,

Departamenti: Drejtoria e Administratës

Numri i Referencës: DA/KJ-13/2024

Koeficienti/Paga mujore: Niveli VII

Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar,

Periudha Provuere: 3 muaj

Detvat dhe Përgjegjësitë:

- Udhëheq Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe monitoron aktivitetet për sigurimin e pajtueshmërisë së kompanisë me kërkesat ligjore relevante si dhe rregullimin e brendshëm të kompanisë sipas Ligjit, Statutit dhe Akteve të Brendshme;
- Harton, plotëson/ ndryshon aktet Juridike, Kontratat, Marrëveshjet dhe të gjitha format e shkresave lidhur me fushë veprimtarinë e kompanisë sipas legjislacionit në fuqi;
- Koordinon aktivitetet të cilat ndërlidhen me Burime Njerëzore.
- Pranon dokumentacionin dhe kujdeset për dokumentet zyrtare dhe shqyrtimin e tyre nga aspekti i çfarëdo implikimi juridik për kompaninë;
- Vënia në dispozicion të dokumenteve të përcaktuara me ligj për inspektim për palët e treta;
- Kujdeset që përmbajtja dhe forma e akteve (shkresave) të jetë e saktë në aspektin ligjor, gjuhësor dhe teknik të cilat ndërlidhen me Burime Njerëzore.
- Koordinimi i aktiviteteve dhe dhënia e këshillave juridike lidhur me kontratat e punëtorëve
- Mbikëqyr vartësit e tij dhe delegon detyra të punës tek ata sipas hierarkisë;
- Kryen punë dhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, të cilat kërkohen nga Drejtuesi i Departamentit të Burimeve Njerëzore
- Pas pranimit të listave të pagave nga zyrtari i burimeve njerëzore e analizon në rast të gabimeve e kthen tek zyrtari për përmirësim dhe pastaj e dërgon tek Drejtuesi i Departamentit të Burimeve Njerëzore
- Për punën e tij i përgjigjet Drejtuesi të Departamentit të Burimeve Njerëzore

Kërkesat e përgjithshme formale

Arsimimi i kërkuar: Diplomë universitare Drejtimi Ekonomik, Juridik, Administratë Publike
Përvoja e punës e kërkuar: 2 vite përvojë pune profesionale

Titulli i vendit të Punës: "Zyrtar për Burime Njerëzore dhe pregtitjen e pagave" në KRM "Pastrimi" SH.A (1) pozitë,

Departamenti: Drejtoria për Administratë

Numri i Referencës: DA/KJ-14/2024

Koeficienti/Paga mujore: Niveli X

Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar,

Periudha Provuere: 3 muaj

Detvat dhe përgjegjësitë:

- Llogaritë orët efektive për secilin punëtor të kompanisë në baza ditore;
 - Raporton në baza mujore për orët efektive për secilin punëtorë;
 - Dërgon në tek Drejtori i Administratës, raportin e orëve efektive të punëtorëve pas aprovimit nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore;
 - Përpilon dhe kalkulon pagat e punonjësve të kompanisë, duke u kujdesur për shtesat në pagë bazuar në Rregulloret e Brendshme të kompanisë dhe legjislacionin në fuqi, pagat për orë shtesë dhe i procedon ato për ekzekutim tek njësia përkatëse përgjegjëse dhe i dërgon tek Udhëheqësi i Zyres së Burimeve Njerëzore
- Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Zyres të Burimeve Njerëzore

Kërkesat e përgjithshme formale

Arsimimi i kërkuar: Diplomë universitare Drejtimi Ekonomik, Juridik, Administratë Publike apo Shkenca Sociale

Përvoja e punës e kërkuar: 2 vite përvojë pune

Kriteret e përgjithshme për praninë në detvër:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- ✓ Aftësi të arsimit logjik dhe analizës;
- ✓ Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- ✓ Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- ✓ Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- ✓ Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- ✓ Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati,
- ✓ Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore,
- ✓ Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës),
- ✓ Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve,
- ✓ Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit, (E dëshirushme).
- ✓ Kopje të Letërnjoftimit,
- ✓ Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale jo më të vjetër se 3 muaj.

Mënyra e aplikimit në konkurs:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në Zyret e Burimeve Njerëzore në KRM "Pastrimi" SH.A.
Të gjitha aplikimet duhet të bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet platformës elektronike; punesimi.krmpastrimi@gmail.com

Data dhe ora e saktë e përmbylljes së Konkursit Publik:

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 15.07.2024 deri me datën 29.07.2024. Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00 të datës 29.07.2024.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së, testit shkrim dhe me intervistim (testi me gojë).

- ✓ CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë,
- ✓ Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë,
- ✓ Intervista (testi me goje) vlerësohet deri në njëzetë (20) pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithësejtë njëqind (100) pikë, ku kalushmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimit elektronik dhe individualisht.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Konkursi Publik i hapur deri me datën 29.07.2024.

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri 7 ditë,

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,

Faza e Intervistes deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistë.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

**REGIONALNA KOMPANIJA ZA PROIZVODNJU OTPADA "Pastrimi" SH. A**

Na osnovu Zakona br. 03/L-212 o radu, član 8 Administrativno uputstvo FPT br. 01/2024 o regulisanju postupka konkursa u javnom sektoru konkretno član 5 stav 1,2 i član 7, Uredba br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u KRM "Pastrimi" SH. A, Odluka od 12.07.2024. godine glavnog izvršnog direktora KRM "Pastrimi" SH. A onda, proglasi ga:

**Interna konkurencija
(Za završetak radnog mesta)**

Radno mesto: "Šef Kancelarije za ljudske resurse" u KRM "Pastrimi" SH. (1) pozicija,

Odeljenje: Direkcija za administraciju

Referentni broj: DA/KJ-13/2024

Mesečni koeficijent/plata: Nivo VII

Trajanje ugovora: Bez fiksnog vremena,

Probni period: 3 meseca

Dužnosti i odgovornosti:

- Upravlja Kancelarijom za ljudske resurse i prati aktivnosti za obezbeđivanje usklađenosti preduzeća sa relevantnim zakonskim zahtevima, kao i interno regulisanje preduzeća u skladu sa Zakonom, Statutom i Internim aktima;
- Nacrti, dovršavanje/ izmene pravnih akata, ugovora, sporazuma i svih oblika radova vezanih za oblast delatnosti preduzeća prema važećem zakonodavstvu;
- Koordinira aktivnosti koje povezuju ljudske resurse.
- Prihvata dokumentaciju i vodi računa o zvaničnim dokumentima i njihovom preispitivanju sa aspekta bilo kakvih pravnih implikacija za kompaniju;
- Izrada dostupnih dokumenata utvrđenih zakonom za inspekciju za treća lica;
- Njime se obezbeđuje da sadržaj i oblik akata (slova) budu ispravni u pravnom, jezičkom i tehničkom smislu vezanom za ljudske resurse.
- Koordinacija aktivnosti i pružanje pravnih saveta u vezi sa ugovorima radnika
- Nadgleda svoje podređene i delegati obavljaju dužnosti prema njima u skladu sa hijerarhijom;
- Obavlja radne i druge dužnosti vezane za opis radnih dužnosti koje zahteva šef Odeljenja za ljudske resurse
- Nakon što je primio platne spiskove od službenika za ljudske resurse, on to analizira u slučaju grešaka, vraća ga službeniku radi poboljšanja, a zatim ga šalje šefu Odeljenja za ljudske resurse.
- Za njegov rad odgovara šef Odeljenja za ljudske resurse

Opšti foKRMalni zahtevi

Potrebno obrazovanje: Univerzitetska diploma Ekonomija, Pravo, Javna administracija

Potrebno radno iskustvo: 2 godine profesionalnog radnog iskustva

Radno mesto: "Službenik za pripremu ljudskih resursa i plata" u KRRM -u "Pastrimi" SH. (1) pozicija,

Odeljenje: Direkcija za administraciju

Referentni broj: DA/KJ-14/2024

Mesečni koeficijent/plata: Nivo X

Trajanje ugovora: Bez fiksnog vremena,

Probni period: 3 meseca

Dužnosti i odgovornosti:

- Izračunavanje efektivnih časova za svakog zaposlenog u preduzeću na dnevnom nivou;
 - Izveštaji na mesečnom nivou za radno vreme za svakog zaposlenog;
 - Upućuje direktoru uprave izveštaj o efektivnom radnom vremenu radnika nakon odobrenja od strane Hr menadžera;
 - Sastavlja i obračunava plate zaposlenih u preduzeću, vodeći računa o dodacima za plate na osnovu Internih propisa preduzeća i važećem zakonodavstvu, zaradama za prekovremeni rad i njihovom postupku za izvršenje u odgovarajućim jedinicama i šalje ih šefu Kancelarije za ljudske resurse
- Za svoj rad odgovara vodi Kancelarije za ljudske resurse

Opšti foKRMalni zahtevi

Potrebno obrazovanje: Univerzitetska diploma Ekonomija, Pravo, Državna uprava ili Društvene nauke

Potrebno radno iskustvo: 2 godine radnog iskustva

Opšti kriterijumi za prijem na dužnost:

- ✓ da budem državljanin Republike Kosovo,
- ✓ Posedovanje najmanje jednog od zvaničnih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Budite u mogućnosti da izvršite odgovarajući zadatak;
- ✓ Da ne bude osuđen za izvršenje krivičnog dela;
- ✓ Imate obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i/ili veštine potrebne za radno mesto
- ✓ Uspešno usvojene procedure prijema određene ovim zakonom.

Znanje, veštine i kvalitete potrebni u postupku regrutacije

- ✓ Sposobnost logičkog rezonovanja i analize;
- ✓ Komunikacione veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost zastupanja.
- ✓ Istraživanje, analitičko, vrednovanje i foKRMulisanje preporuka i stručnih saveta;
- ✓ Sposobnost donošenja nezavisnih stručnih presuda i vršenja diskrecije po pitanjima i davanja značajnog doprinosa razvoju i sprovođenju politike;
- ✓ Obimno poznavanje terena, metode istraživanja, koje pomažu u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

Dokumenti koji će biti dostavljeni u sklopu zahteva i način njihovog podnošenja

- ✓ Prijava završena i potpisana od strane kandidata,
- ✓ Kopija diploma koje dodeljuju obrazovne ustanove,
- ✓ Kopija uverenja o zaposlenju (Penziono poverenje, sertifikat ili ugovor o radu),
- ✓ Dokazi o obukama i kursovima,
- ✓ Kopija procene rada za poslednje dve godine, (Poželjno).
- ✓ Kopije ID-a,
- ✓ Osuđujuća presuda da nije osuđen za krivično delo ne starije od 3 meseca.

Način prijave na konkursu:

Zainteresovani kandidati, zvaničan obrazac možete dobiti u kancelarijama za ljudske resurse u KRM "Cleaning" SH.A.

Sve aplikacije moraju da se prave elektronskim putem samo preko elektronske platforme KRRMe; punesimi.kKRMpastrimi@gmail.com

Tačan datum i vreme završetka javnog konkursa:

Javni konkurs traje 15 dana od 15.07.2024 do 29.07.2024. Poslednji put prijem prijave je 16:00 časova 29.07.2024.

Sve prijave koje stignu posle isteka roka neće biti u razmatranju.

Način ocenjivanja i kriterijumi ocenjivanja.

Ocenjivanje kandidata se radi na osnovu CV-ja, pismenog testa i intervjuisanja (oralni test).

- ✓ CV kandidata ocenjen je sa do deset (10) poena,
- ✓ Pismeni test se procenjuje do sedamdeset (70) poena,
- ✓ Intervista (oralni test) se procenjuje na dvadeset (20) poena.

Postupak procene sadrži stotinu (100) tačaka, gde je pastiš ostvarenje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog takmičenja.

Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima.

Svi kandidati biće obavešteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

Približan raspored procedure regrutacije:

Javni konkurs otvoren do 29.07.2024.

Preliminarna faza verifikacije aplikacija do 7 dana,

Pisana test faza do 10 dana nakon faze verifikacije,

Faza intervjua do 7 dana nakon što su objavljeni pisani rezultati testa.

Objavlivanje rezultata do 5 dana nakon ocenjivanja intervjua.

Napomena: Neotkrivena, neos skenirana dokumenta i ona koja stignu po isteku roka konkursa neće biti ispitana.

Thirrja për aplikim (DHËNJE TË OFERTËS)

"Farma Ensari & Orgesi" SH.P.K. me Numer Unik.Biz: 812177229 me seli te biznesit në Adresa: RR. "Brigadat e Lirisë", pn Keqekolle, **komuna Prishtine**, po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për **mallrat/punët/shërbime** këshilluese si në vijim:për kompanit e Interesuara për Ofertim të këtyre Makinerive dhe Paisjeve Bujqësore dhe energji solare:


1. Traktor 4x4 me kabine dhe klime
2. Shprendarese e plehut organik,
3. Mikser per ushqimin e kafsheve,
4. Mbeshtjellese e rrotoballave,
5. Energjia Solare.

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek "Farma Ensari & Orgesi" "SH.P.K. pronare **Igballe Bytyqi** (Përfituesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë **(5 ditë nga data e publikimit)**

Afati i dorezimit të Ofertave **10 ditë nga data e pranimit te ftesave** per kuotim, ofertat dorëzohen ne Adresen: RR. "Brigadat e Lirisë", pn Keqekolle **komuna Prishtine**
Për Informata Shtesë tel: +38344594422

dhe në email adresën: i-gballe001@hotmail.com



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qëndresa Tara nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Ajete Boshnjaku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Zgjim Dana nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e maturës së Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Qëndresa Tara nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e maturës së Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Ajete Boshnjaku nga Gjakova shpall të pavlefshme deftesat e klasës 10,11,12 të Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Njomza Hajdari shpall te pavlefshme deftesat e kl VI - IX shfmu "28 Nentori".

- Brodosane Sherif Bajrami shpall te pavlefshme diplomen Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Masar Masar Ramadani shpall te pavlefshme deftesat e kl VI- IX shfmu "28 Nentori".

- Brodosane Enis Krasniqi shpall te pavlefshme 4 deftesat Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992





ROYAL CROWN
RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908
0.5L